



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA SHTIME



STRATEGJIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK LOKAL
2019-2022
(Draft Plani)

Mars, 2019



PËRMBAJTJA

SHKURTESAT DHE AKRONIMET	4
1. HYRJE	6
2. ANALIZA E GJENDJËS AKTUALE	8
2.1. Gjendja demografike dhe gjeografike	8
2.2. Sektori i zhvillimit ekonomik dhe bizneset	12
2.3. Sektori i bujqësisë	15
2.4. Turizmi	16
2.5. Indikatorët e tjerë të zhvillimit ekonomik	17
2.5.1. Arsimi	17
2.5.2. Infrastruktura	18
2.5.3. Aktivitet në kulturë dhe sport	19
2.5.4. Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	20
2.5.5. Buxheti i Komunës	21
3. PËRMBLEDHJA E ANALIZËS SWOT	22
4. VIZIONI	24
5. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT	25
6. AKTIVITETET DHE SPECIFIKIMI I PROJEKTEVE	28
7. PROJEKTET NË RAPORT ME QËLLIMET	35
8. PLANIFIKIMI I BUXHETI	40
9. METODOLOGJIA DHE TË DHËNAT	54
10. ANEKSET	55



Tabela	Përshkrimi	Faqe
Tabela 1.	Struktura e popullsisë sipas grup moshave	8
Tabela 2.	Struktura sipas përkatësisë etnike	9
Tabela 3.	Bizneset dhe numri i punëtorëve në Komunën e Shtimes	14
Tabela 4.	Struktura e institucioneve arsimore dhe nxënësve	17
Tabela 5.	Investimeve në infrastrukturë e shprehur në njësi matëse (km, m ²) ¹	18
Tabela 6.	Shpenzimi i Buxheti sipas viteve	21
Tabela 7.	Buxhetit i planifikuar për vitin 2019	21
Tabela 8.	Projeksionet e shpenzimeve buxhetore Komunale	21
Tabela 9.	SWOT Analiza	22
Tabela 10.	Aktivitetet dhe specifikimi i projekteve	28
Tabela 11.	Projektet në raport me qëllimet	35
Tabela 12.	Planifikimi i buxhetit	40

¹ Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi



SHKURTESAT DHE AKRONIMET

SWOT	Vlerësimi i aftësive konkurruese
ZHEL	Zhvillimi Ekonomik Lokal
SZHEL	Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal
NVM	Ndërmarrje të Vogla e të Mesme
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
OJQ	Organizata joqeveritare
VDA	Vizioni Drejt Ardhmërisë
DSHMS	Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Q	Qëllimet
O	Objektiv
A	Aktivitetet
P	Projekt
Q1	Qëllimi i parë
Q2	Qëllimi i dytë
Q3	Qëllimi i tretë
Q4	Qëllimi i katër
Q5	Qëllimi i pestë
Q6	Qëllimi i gjashtë
Q7	Qëllimi i shtatë
Q8	Qëllimi i tetë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë



MAPH	Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor
MZHR	Ministria e Zhvillimit Rajonal
MF	Ministria e Financave
SHMP	Shkolla e Mesme Profesionale



1. HYRJE

Komuna e Shtimes bënë planifikimet strategjike në të gjithë sektorët e saj qeverisës (arsim, ekonomi, zhvillim rural dhe turizmit) me qëllim të përmirësimit të jetës së qytetarëve.

Qëllimi i hartimit të këtij plani strategjik është avancimi dhe realizimi i një sërë aktiviteteve në sektorin e ekonomisë dhe biznesit, bujqësisë dhe mirëqenien e qytetarëve.

Komuna do të jetë një qendër e rëndësishme ekonomike, me një sistem modern të mbrojtjes sociale, ku do të harmonizohen faktorët natyrorë e historik, ku do të ndihen mirë e do të bashkëjetojnë në harmoni gjithë grupet shoqërore, një vend për të jetuar mirë.

Hartimi i dokumentit Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2019-2022 bazohet në Model-Strategjinë dhe Model-Planin për Zhvillim Socio-Ekonomik Lokal, është dokument politikash i MAPL-së me qëllim të përkrahjes së komunave në hartimin e dokumenteve strategjike që ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal.

Model-Strategjia dhe Model-Plani për Zhvillim Socio-Ekonomik Lokal është hartuar mbi bazën e Planit Vjetor të Punës së MAPL-së dhe është në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr.07/2018 për procedurat, kriteret dhe metodologjinë e përgatitjes dhe miratimit të dokumenteve strategjike dhe planeve për zbatimin e tyre.

Komuna e Shtimes që nga viti 1999 e deri më tani ka qenë bashkëpunuese në realizimin e projekteve me Qeverisjen Qendrore, Donatorët dhe OJQ-të ku edhe janë shënuar rezultate të dukshme si për shembull krijimi i Zonës Ekonomike në Shtime në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, po ashtu edhe themelimi i Qendrës së Agrobiznesit në këtë Zonë Ekonomike në bashkëpunim me Zyrën e Komisionit Evropian.

Qeveria e Kosovës i ka dhënë prioritet:

1. Rritjes së qëndrueshme ekonomike për të ulur nivelin e varfërisë dhe përmirësimin e jetës së grupeve në nevojë dhe grupeve me probleme sociale;
2. Rritjes së ritmeve të zhvillimit për të përmbushur standardet e Integritetit Evropian.

Strategjia do të ndërlidhet me prioritetet e Qeverisë së Kosovës për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm pasi në këtë fushë edhe qeverisja komunale ka obligim ligjor dhe interes për realizimin e synimeve të përbashkëta.

Ky planë është i ndarë në dhjetë kapituj. Në kapitullin e parë është bërë përmbledhje e shkurtër e këtij plani (diskutim i përgjithshëm). Në kapitullin e dytë është bërë analizimi i gjendjes aktuale në Komunën e Shtimes. Fokus kryesor të kësaj analize janë bërë për gjendjen në zhvillim



ekonomik, cikli i zhvillimit të bizneseve, analizimi i sektorit të bujqësisë dhe gjendja aktuale e turizmit. Përveç indikatorëve direkt të zhvillimit ekonomik në këtë kapitull janë analizuar edhe indikatorët tjerë si arsimi, infrastruktura, rinia dhe sporti. Në këtë kapitull janë bërë gjetjet e problemeve, sfidave, mundësit dhe përfitimet e që kanë qytetarët nga investimet e deri tanishme, ku me këtë rast dalin edhe planifikimi i aktiviteteve në të ardhmen. Në kapitullin tre është bërë analiza SWOT e realizimit të projekteve. Në kapitullin katër është paraqitur vizioni i Planit Strategjik. Në kapitullin pesë janë paraqitur qëllimet dhe objektivat strategjike. Në kapitullin gjashtë është bërë specifikimi i projekteve. Në kapitullin shtatë është bërë shqyrtimi i projekteve në raport me qëllimet strategjike. Në kapitullin tetë është bërë planifikimi i buxhetit. Në kapitullin nëntë bëhet përshkrimi i metodologjisë së punimit të këtij plani strategjikë dhe në kapitullin e fundit janë anekset.

Metodologjia e punimit të këtij plani është bërë nga ekipet punuese dhe ekspertë të fushave të ndryshme. Për analizimin e gjendjes ekzistuese janë përdorur metoda narrative, metoda krahasuese dhe metoda matëse statistikore.

Të dhënat e përpunuara në këtë plan janë të dhëna të gjeneruara nga planet e zhvillimit lokal, strategjia zhvillimit ekonomik 2014-2018, statistika e marra nga sektorë të ndryshëm të Komunës së Shtimes dhe raporte e tjera të fushave përkatëse.



2. ANALIZA E GJENDJËS AKTUALE

2.1. Gjendja demografike dhe gjeografike

a) Numri i popullsisë

Komuna Shtimes gjendet në pjesën qendrore të Kosovës dhe përfshin qytetin e Shtimes dhe 22 fshatra me një popullsi prej 27,324 banorë² me 4.158 familje dhe me një dendësi popullsie 203.91 banorë/km² dhe moshë mesatare 27.62 vjeç.

Në bazë të të dhënave të marra nga regjistrimi i popullsisë³ së vitit 2011 publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës shihet se numri i popullsisë në komunën e Shtimes është 27,324 banorë ku prej tyre 13,850 janë të gjinisë mashkullore, ndërsa 13,474 janë të gjinisë femërore.

Tabela 1. Struktura e popullsisë sipas grup moshave

Grup moshat	Numri i grup moshës f	Përqindja	Mosha (Mesi i intervalit) x	$f \cdot x$
0 - 9	5,428	19.87	4.5	24426.0
10 - 19	6,124	22.41	14.5	88798.0
20 - 29	4,443	16.26	24.5	108853.5
30 - 39	3,970	14.53	34.5	136965.0
40 - 49	3,016	11.04	44.5	134212.0
50 - 59	1,988	7.28	54.5	108346.0
60 - 69	1,386	5.07	64.5	89397.0
70 - 79	725	2.65	74.5	54012.5
80+	244	0.89	40	9760.0
Gjithsej	27,324	100		754,770.0

$X = \frac{\sum fx}{\sum f} = \frac{754,770}{27,327} = 27.62$ vjet mosha mesatare e popullsisë në komunën e Shtimes

$$\sum f = 27,327$$

² Regjistrimi i Popullsisë i vitit 2011 - Agjencia e Statistikave të Kosovës

³ Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjar edhe Banesave në Kosovë 2011



Struktura e popullsisë që jetojnë në vise rurale dhe urbane ka këtë pjesëmarrje: Popullsia Urbane me 7,255 banorë ose 26.55% dhe Popullsia Rurale me 20,069 banorë ose 73.45%.

Ekonomit familjare në komunën e Shtimes janë 4,158 me 6.57 mesatarja për familje.

Tabela 2. Struktura sipas përkatësisë etnike

Përkatësia etnike	Numri	Përqindja
Nuk janë në dispozicion	19	0.07
Shqiptar	26,447	96.79
Serb	49	0.18
Turk	1	0.00
Boshnjak	20	0.07
Rom	23	0.08
Ashkali	750	2.74
Egjiptian	0	0.00
Goran	2	0.01
Të tjerë	13	0.05
Preferon mos të përgjigjet	0	0.00
Gjithsej	27,324	100

Norma mesatare vjetore e shtimit (nataliteti) sipas vitit 2011 është 536 lindje nga të cilat 290 të gjinisë mashkullore ndërsa 246 të gjinisë femërore ose shprehur në promilë është 19.61‰.

Norma mesatare vjetore e vdekjeve (mortaliteti) sipas vitit 2011 është 85 vdekje nga të cilat 55 të gjinisë mashkullore ndërsa 30 të gjinisë femërore ose shprehur në promilë është 3.11‰.

Pra, mund të konkludojmë se shtimi natyror për vit, në komunën e Shtimes, është 16.5‰.

Dendësia e popullsisë sipas regjistrimit të vitit 2011 është 203.91 banorë në 1km².


Qyteti i Shtimes, qendra administrative e komunës ka klimë kontinentale me reshje mesatare 673mm në vit dhe temperatura mesatare -1.4°C në janar dhe 20.6°C në korrik.

Në vendbanimet e komunës së Shtimes gjenden gjurmë të trashëgimisë historike e kulturore që prej kohës së neolitit, ilirëve, romakëve dhe vazhduar me ato të Perandorisë Osmane. Sipas defterit kadastral të vitit 1455 Shtimja i takonte Vilajetit të Vushtrrisë dhe ishte nën pushtimin osman. Në vitin 1566-74 i takonte Nahijes së Moravës me qendër në Prishtinë. Ndërsa në shekullin XIX i takonte Sanxhakut të Prizrenit.



b) Sipërfaqja

Komuna Shtime ka një sipërfaqe prej 134km² (13.450,8ha) dhe shtrihet në pjesën Qendrore të Kosovës, kufizohet me komunën e Ferizajt, Lipjanit dhe Therandës (Suharekës). Qendra administrative, qyteti i Shtimes është 31km larg kryeqytetit të Kosovës - Prishtinës, 45km larg Prizrenit dhe 13km nga Ferizaj.



Pozicioni dhe ndarja e Komunës se Shtimeve sipas vendbanimeve

Qyteti i Shtimes gjendet 31km larg aeroportit ndërkombëtar të Prishtinës, 259km larg portit të Durrësit 220km larg portit të Shëngjinit si dhe pozicionohet mes akseve të rëndësishme rrugore Prizren - Prishtinë dhe Prizren - Ferizaj - Shkup.

Qyteti	1	Tokë bujqësore	48,4 %
Fshatra	22	Pyje	47,4 %
Sipërfaqja	134 km ²	Rrugë urbane	15.54 km
Popullsia	27,2324 banorë	Rrugë komunale	107.22 km
Nr. Familjeve	4,158	Dendësia për banorë/km ²	203.91
Popullsi urbane	7,255	Meshkuj	50,69%
Popullsi rurale	20,069	Femra	49,31%



Komuna Shtime ka nën administrimin e saj qytetin e Shtimes dhe 22 fshatra, 13 prej të cilëve shtrihen në zonën kodrinore - malore dhe 9 në zonën fushore.

Komuna e Shtimes njihet si njësi territoriale - administrative që nga fillimi i shekullit XX, më saktësisht që prej Luftës së Parë Botërore. Komuna e humbet më 1932 statusin e saj për shkak të politikës shoviniste serbe të udhëhequr nga Mbretëria e atëhershme jugosllave. Pas Luftës së Dytë Botërore (1945), Shtimja ka funksionuar sërish si komunë, për ta humbur statusin përsëri në vitin 1959. Më 9 Qershor të vitit 1988 është ri themeluar Komuna e Shtimes dhe sot është qendër komunale administrative e 22 fshatrave.

c) Pasuritë natyrore

Komuna e Shtimes njihet për rezervat e mëdha të gurit gëlqeror, të cilat sipas matjeve të kryera në vargmalet nga Carraleva në Topillë, janë rreth 2 milionë metra kub rezerva të cilësisë së lartë, ndërkohë që ka pritshmëri dhe për rreth 9 milionë metra kub rezerva të tjera të po kësaj cilësie, duke përbërë në këtë mënyrë një mundësi shumë të madhe për ngritjen e një industrie nxjerrëse dhe përpunuese për materiale që përdoren në sektorin e ndërtimit.

Territori i komunës së Shtimes është i pasur me lumenj. Lumi i Carralevës është një ndër bukuritë natyrore të zonës, në hyrje të Shtimes bashkohet me lumin i cili buron nga malet e Topillës, për t'u bashkuar më pas në qytetin e Shtimes me lumin Shtimjanja dhe duke vazhduar nëpër fshatra dhe bashkohet me lumin Sitnica. Pellgu i lumit Shtimjanja ka një sipërfaqe prej 14km² dhe një gjatësi afër 15km. Përveç këtij lumi ekzistojnë edhe burime të tjera si ai në Qarrishtë, Raçak etj.

Rezervat ujore janë një resurs mjaft i mirë për zhvillimin e bujqësisë, si burim energjetik, por dhe si mundësi zhvillimit të turizmit. Toka bujqësore përbën rreth 48,4 % të territorit të

komunës dhe bujqësia është dhe mbetet një nga prioritetet zhvillimore të saj. Komuna ka rreth 6697ha tokë bujqësore, prej të cilave 4.947 ha janë pjellore. Kullotat zënë një sipërfaqe rreth 1750ha, ndërsa pyjet 6377.8ha ose rreth 47.4 % të territorit të Komunës, nga të cilat 45.9% (2926.8 ha) janë publike dhe 54.1% (3451 ha) në pronësi private duke përbërë një aks shumë të rëndësishëm për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë.



2.2. *Sektori i zhvillimit ekonomik dhe bizneset*

Një prej institucioneve më të rëndësishme që vepron në Komunë është Drejtoria për Zhvillim Ekonomik⁴. Drejtoria është e pajisur me një kuadër të trajnuar, i cili ofron mbështetje të plotë zhvillimit të biznesit dhe atij ekonomik në komunë. Në bashkëpunim të ngushtë me qendrën biznesore komunale, administrata komunale ofron një varg shërbimesh biznesore, duke filluar nga shërbimet për regjistrim të biznesit deri në mbështetje të plotë të investuesve.

Administrata i kushton vëmendje të madhe efikasitetit. Të gjitha kërkesat e komunitetit biznesor procedohen me shpejtësi dhe kujdes të veçantë për t'i plotësuar të gjitha nevojat e tyre. Duke e parë nevojën e krijimit të një mjedisi të përmirësuar biznesor, komuna ka ndërmarrë një nismë për ofrimin e vëmendjes së veçantë tërheqjes së investimeve, përmes ofrimit të mundësive të ndryshme, me fjalë tjera, me zvogëlim të tatimit, me stimulim dhe beneficione tjera preferenciale investuesve. Krahës kësaj, komuna ka adoptuar një qasje më pro-aktive ndaj partneritete publike-private dhe dhënies së tokës koncesionale për tërheqje të investimeve. Një e dhënë me rëndësi është edhe mbledhja e informatave më të fundit mbi pronën komunale që na ofron Plani Zhvillimor Komunal 2009- 2019. Kjo tregon që shfrytëzimi i këtyre pronave mund të sjell zhvillim ekonomik të qëndrueshëm nëpërmjet të cilit mund të krijohen vende pune si dhe rritje të hyrave vetanake që do të mund të shfrytëzoheshin nga komuna për përmirësimin efektiv të infrastrukturës dhe shërbimeve tjera komunale.

REGJISTRIMI I BIZNESIT DHE ZYRA “ONE STOP SHOP”

Që nga muaji korrik i vitit 2012 funksionon Zyra për Regjistrimin e Bizneseve, e cila, përveç regjistrimit të bizneseve, ajo ju ofron edhe këshilla, trajnime në fushën e të bërit biznes dhe

informacione se si do të kenë qasje në kuptimin e asaj për nevoja dhe projekte. Bizneseve të komunës së Shtimes kjo zyre tani po u zvogëlon koston financiare edhe atë të kohës që janë dy faktorë që i duhen më shumë biznesit. Kjo zyre është një aktivitet shtesë dhe përmirëson klimën e të bërit biznes. Komuna e Shtimes ka qenë përfituese e dy çmimeve për të bërit biznes nga USAID-i. Zyra për Regjistrimin e Bizneseve synon të përmirësojë ambientin e biznesit në Shtime, me

⁴ Drejtoria për Zhvillim Ekonomik



qëllim të rritjes së zhvillimit ekonomik dhe punësimit. Me këtë thjeshtësohen dhe lehtëson procedurat administrative për regjistrimin dhe licencimin e bizneseve në kuadër të komunave, mandej zvogëlojnë kohën, procedurat dhe shpenzimet. Komuna e Shtimes ka krijuar zyrën për mbështetjen e biznesit dhe është një ndër gjashtë komunat e regjionit qendër ku është duke u zbatuar ky projekt.

d) Struktura ekonomike

Zona Ekonomike - Parku Teknologjik në Shtime

Zona Ekonomike në Shtime gjendet në kilometrin e dytë në rrugën magjistrale Shtime - Ferizaj (M-25.3).

Zona përfshin një sipërfaqe prej 10.7ha.

Në Parkun Teknologjik në Shtime janë të vendosura 12 biznese, 7 prej tyre kanë filluar veprimtarin, 5 biznese janë në fazën e investimeve kapitale. Numri i të punësuarve në Parkun Teknologjik është 105 në vitin 2018 dhe deri në vitin 2020 numri i të punësuarve do të rritet në 160. Bazuar në planet e biznesit në Parkun Teknologjik do të punësohen 217 punëtor të rregullt dhe rreth 100 sezonal ndërsa vlera e planifikuar e investimeve është 9,968,200€



Zona Ekonomike në Shtime



Qendra e Agrobiznesit në Shtime

Në komunë e Shtimes zhvillojnë aktivitetin 1878 biznese të regjistruara⁵ (deri më 31.12.2018), struktura sektoriale e të cilave është si në Tabelën 3.

⁵Drejtoria për ZhvillimEkonomik



Tabela 3. Bizneset dhe numri i punëtorëve në Komunën e Shtimes

Nr .	Veprimtarit e bizneseve	Individuale	Shpk	Kooperativa bujqësore	Shoqëri Aksionare	Ortakëri	Numri i bizneseve gjithsej
1	Bujqësi, Pylltari dhe Peshkatar	105	7	4	0	1	117
2	Xehetari dhe gurëthyes	9	11	0	0	1	21
3	Prodhim	170	31	0	0	2	203
4	Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	0	4	0	0	0	4
5	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete të rivitalizimit	6	1	0	0	0	7
6	Ndërtimtari	146	31	0	0	3	180
7	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	616	51	1	1	16	685
8	Transport dhe ruajtje	193	5	0	0	0	198
9	Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	176	10	0	0	0	186
10	Informacion dhe komunikim	21	6	0	0	1	28
11	Aktivitete financiare dhe siguri	3	1	0	0	0	4



12	Aktivitetet të patundshmërisë	3	0	0	0	0	3
13	Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	24	13	0	0	0	37
14	Aktivitetet administrative dhe mbështetëse	15	4	0	0	0	19
15	Administratë publike dhe mbrojtje	1	0	0	0	0	1
16	Arsim	12	2	0	0	2	16
17	Shëndetësi njerëzor dhe aktivitetet e punës sociale	23	3	0	0	0	26
18	Art, zbavitje dhe rekreacion	31	6	0	0	0	37
19	Aktivitetet të shërbimeve të tjera	104	2	0	0	0	106
Gjithsej		1658	188	5	1	26	1878

2.3. *Sektori i bujqësisë*

Komuna e Shtimes e ka në traditën e saj marrjen me bujqësi⁶, veçanërisht kultivimin e drithërave të bardha si grurin, misrin, thekrën, tërshërën dhe disa kultura të pemëve frutore: faroret, bërthamoret dhe aroret si dhe pemët e imta dredhëza, mjedra, kulturat perimore në ambiente të mbyllura dhe ambient të hapur: specat, domatet, trangujt, lakra etj, si rrjedhojë e sipërfaqes së madhe të tokës bujqësore dhe pjellorisë së saj, por edhe të burimeve të mëdha ujore dhe kapaciteteve njerëzore që zotëron.

⁶ Sektori për Bujqësi, pylltari dhe Zhvillim Rural



Vitet e fundit, bujqësia ka marrë një zhvillim të ri për shkak të kultivimit në mënyrë intensive të kulturave bujqësore, por dhe rritjes së vetëdijes së fermerëve që bujqësia është prioritet zhvillimor në komunën Shtime. Si rezultat i kësaj po zvogëlohen sipërfaqet me kultivimin e drithërave të bardha në favor të kulturave intensive.

Duhet veçuar se zhvillim të hovshëm ka marrë edhe rritja dhe kultivimi i Bletës, ku tani janë 49 bletarë me gjithsej 2884 shoqëri bletësh.

Pemishte komerciale të ngritura janë 78.64ha.

Vetëm gjatë këtyre viteve të fundit janë ngritur mbjell 42ha pemishte me mollë dhe kumbull të kultivuara në mënyrë intensive, mbi 8.5ha serra për kultivimin e perimeve dhe luleve, rreth 88.63ha me perime në sipërfaqe të hapur.

Janë ngritur 5 ferma të pulave për prodhimin e vezëve me mbi 30000 pula vojse dhe një fermë për trashjen e zogjve me kapacitet prej 3600 zogj, janë të ngritura edhe 21 ferma për prodhimin e qumështit me 227 krerë dhe 5 ferma për trashjen e viçave me 125 krerë, 12 ferma të deleve me 1254 krerë dhe 4 ferma të dhive me 233 krerë.

Që nga viti 2014 në Parkun Teknologjik operon Qendra e Agrobiznesit, e cila tregton pemë dhe perime brenda dhe jashtë Kosovës.

2.4. Turizmi

Në komunën e Shtimes janë të shpallura 3 zona turistike, Llanisht- Topillë, Rancë-Carralevë dhe Dugë. Vlera më e madhe në turizëm është pjesa malore, e cila gjendet në perëndim të qytetit, në fshatrat Mollopolc, Devetak, Llanisht, Topillë, Rancë Carralevë dhe Dugë. Në këto vargmale ka peisazhe natyrore shumë të bukura. Në këto zona gjenden mbi 200 burime të ujit, po ashtu atraksion i veçant janë Shpella e Imer Devetakut dhe Shpella e Lakuriqëve. Është shpallur edhe zona turistike Mollopolc-Devetak e cila ka bukur natyrore në veçanti ujëvara e Mollopolcit, mbi 90 burime të ujit, lumin dhe pyjet e bukura.



2.5. Indikatorët e tjetre të zhvillimit ekonomik

2.5.1. Arsimi

Procesin edukativo-arsimor⁷, nga ai parashkollor, deri në shkollimin e mesëm të lartë, e ndjekin 5987 nxënës, të cilët kanë në dispozicion një institucion parashkollor, shtatë shkolla fillore dhe të mesme të ulëta me 10 paralele të ndara, një gjimnaz si dhe një shkollë të mesme profesionale.

Tabela 4. Struktura e institucioneve arsimore dhe nxënësve

Institucionet arsimore	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Institucioni parashkollor – çerdhja	28	28	56
Arsimi para fillor 5 - 6 vjeç	220	201	421
Arsimi fillor (1 - 5)	1125	1053	2178
Arsimi i mesëm i ulët (6 - 9)	943	919	1862
Gjimnazi (10 - 12)	360	426	786
Drejtmet Profesionale (10 - 12)	438	246	684
Gjithsej	3114	2873	5987

Politikat arsimore janë qendrore, ndërsa komuna luan rol të rëndësishëm në kuadër të kompetencave ligjore në mirëmbajtjen e ambienteve dhe në ofrimin e bashkëpunimit që synon rritjen e kapaciteteve dhe prioritetet e zhvillimit komunal. Sipërfaqet e mëdha të tokës bujqësore (48,4%) dhe të pyjeve (47,4%) krijojnë mundësi që nëpërmjet zhvillimit të “kurrikulave shkollore” jo vetëm që institucionet arsimore të ndihmojnë në zhvillimin e komunitetit arsimor natyror, por që edhe nëpërmjet aftësimit për lëmin e bujqësisë, teknologjisë së përpunimit të ushqimit dhe të veterinarisë si dhe hapjen e profilit për turizëm në Shkollën e Mesme Profesionale të ndikojnë në uljen e papunësisë rritjes së Bruto Produktit të Përgjithshëm, Indeksit të Zhvillimit Human dhe të kapitalit social

⁷ Drejtoria për Arsim



2.5.2. Infrastruktura

Infrastruktura⁸ e komunës Shtime është zhvilluar në përputhje me planet urbanistike dhe strategjitë e zhvillimit, për rrjedhojë në një periudhë rreth 18 vjeçare janë investuar 44,647,540.00€ në 533 projekte, të cilat janë destinuar për shtrimin e rrugëve (159.73km), ndërtimin e ujësjellësve (104.72km), kanalet e ujërave të zeza (74.65km) si dhe shtrim trotuaresh, sipërfaqe të gjelbëruara, ndriçim publik etj. Fshatrat e Komunës janë të lidhura me rrugë të asfaltuara me qytetin e Shtimes, duke krijuar në këtë mënyrë një avantazh për zhvillimet e mëtejshme ekonomike, zhvillimin turizmit dhe zhvillimin social të komunës.

Tabela 5. Investimeve në infrastrukturë e shprehur në njësi matëse (km, m²)⁹

NR.	Viti i realizimit	Njësia	Numri i kilometrave - rrugë të asfaltuar	Numri i kilometrave - në ujësjellës	Numri i kilometrave - kanalizim atmosferik	Numri i kilometrave - kanalizim fekal	Numri i kilometrave të trotuareve	Sipërfaqja hapësirave gjelbëruara, parqeve në m ²	Ndriçim Publik në km
1	2000	km	0	5	0	0	0	0	0
2	2001	km	0	5.5	0.55	0.45	0	0	0
3	2002	km	0	6	0.1	2.4	0.8	0	0
4	2003	km	1.05	29.9	0	0	0	0	0
5	2004	km	0	19.6	0.85	1.8	1.2	0	0
6	2005	km	3.03	13.7	0.48	0	0	0	0
7	2006	km	1.12	15.3	0	0	0.6	0	0
8	2007	km	3.76	1.2	1.88	0	1.6	2000	0
9	2008	km	8.9	1.4	1.2	0	1.8	0	0
10	2009	km	25.7	1.5	3.6	8.3	4	1400	0
11	2010	km	1.47	1.8	0.8	4.3	2.8	1200	0
12	2011	km	6.5	1.2	0	10.8	2.8	300	6.44
13	2012	km	19.96	0.8	0	10.5	0	0	0
14	2013	km	51.27	1.2	0.7	13.6	0	500	2.2
15	2014	km	32.51	2.5	2.8	6	2.6	0	0.6
16	2015	km	3.67	0	0.41	12.37	3.5	8881	2.2
17	2016	km	3.35	0.6	0.69	3.51	1.9	830	2.1
18	2017	km	1.20	0	0.65	0.62	1.2	1320	1.0
19	2018	km	15.16	0	13.32	9.28	7.8	9195	2.87
Gjithsej			175.33	104.72	28.03	83.93	32.6	25626	17.41

⁸ Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi

⁹ Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi



2.5.3. Aktivitet në kulturë dhe sport

Në komunën e Shtimes zhvillojnë aktivitetin e tyre kulturor¹⁰ dhe artistik disa shoqëri, ku spikat Ansambli i Këngëve dhe Valleve “Dita” nga qyteti i Shtimes. Biblioteka e Qytetit me fondin e saj të librave që pasurohet çdo ditë, i jep qytetit një dimension të ri kulturor. Gjithashtu, me qëllim ruajtjen e relikteve historike dhe njohjen e së kaluarës historike të trevës së Shtimes, e cila ishte mjaft e bujshme, me plot sakrifica e luftëra për liri, më 19.1.2004 është themeluar Muzeu i Qytetit, për të cilin kujdeset Drejtoria për, Kulturë, Rini dhe Sport.

Historia e komunës së Shtimes lidhet me disa objekte përkujtimore si: Varrezat e Dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Shtime dhe Mollopolc, Kompleksi Memorial “Masakra e Raçakut” si dhe një numër objektesh të kultit, si kisha, xhami dhe tyrbe, varri i Ahmet Sylejmanit – Shtimja - kryetari i parë shqiptar në Shtime. Qendra Rinore në Shtime synon masivizimin e aktiviteteve me karakter kulturor dhe social të rinjve. Komuna e Shtimes ka të themeluar Këshillin e Veprimit Rinor Lokal të rinjve ku janë të përfshira 13 OJQ aktive. Sporti në Komunë do të marrë një dimension të ri me përfundimin e palestrës sportive, aktualisht klubet sportive dhe shoqatat rekreative - sportive janë shumë aktive.

Objektet kulturore: Muzeu i Qytetit i restauruar në vitin 2015, Shtëpia e Kulturës funksionon nga viti 2015, aktualisht është duke u restauruar objekti i Qendrës Rinore.

Trashëgimia kulturore: Në komunën tonë kemi 10 objekte të trashëgimisë kulturore që janë në mbrojtje të përkohshme nga Ministria e Kulturës duke përfshirë edhe xhamia, kisha, tyrbe, varreza e shumë objekte tjera.

Stadiumi i futbollit është në funksion të futbolldashësve dhe sportistëve në përgjithësi.

Në komunën tonë janë aktivë këto klube sportive të cilat u japin hapësirë të gjithë të rinjve për të treguar vlerat e tyre sportive, Klubi i Hendbollit Vajzat, Klubi i Hendbollit Meshkujt, Klubi i Futbollit, Klubi i Boksit, Klubi i Kik boksit, Klubi i Karatesë, pastaj kemi shoqatat rekreative – sportive Shoqata e peshkatarëve, Shoqata e bjeshkatarëve, Shoqata e sportit shkollor, moto kros-një sport atraktiv që po zhvillohet edhe në komunën tonë etj.

KVRL - është aktiv dhe ka shumë organizata të kyçura dhe vullnetarë të rinj. Qendra Rinore është licencuar në vitin 2016.

¹⁰ Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



2.5.4. Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale

Kujdesi shëndetësor¹¹ në komunën e Shtimes është i organizuar dhe ofrohet përmes sektorit publik shëndetësor dhe atij privat. Komunitet janë përgjegjëse për kujdesin parësor shëndetësor publik dhe për vlerësimin e gjendjes shëndetësore të qytetarëve në territorin e tyre.

Kujdesi Primar Shëndetësor Publik ofrohet përmes: Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare-QKMF “ Dr Vezir Bajrami” në Shtime dhe katër Qendrave të Mjekësisë Familjare në fshatrat: Muzeqinë, Pjetërshicë, Petrovë dhe Godanc. Veprimtaria e QKMF-së është ofrimi i shërbimit parësor shëndetësor për qytetarët e komunës, si një veprimtari me interes të veçantë shoqëror, përmes zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare në kuadër të sistemit unik shëndetësor të Kosovës.

Koncepti i mjekësisë familjare konsiston që banorëve të komunës së Shtimes dhe të tjerëve, sipas shtrirjes territoriale dhe gjeografike, t’u ofroj shërbim shëndetësor gjithëpërfshirës, të bazuar në të dhëna shkencore dhe efikase, përmes caktimit të mjekut familjar, i cili do të jetë portë hyrëse për pacientët në sistemin shëndetësor dhe njëherit pikë referuese në nivele tjera të kujdesit shëndetësor dytësor dhe tretësor.

Shërbimet sociale profesionale dhe asistencës sociale për qytetarët tanë ofrohen përmes Qendrës për Punë Sociale (QPS), në Shtime, ku funksionojnë dy shërbime: Shërbimet Sociale

Profesionale dhe Skema e Ndhimave Sociale. QPS e ka statusin e institucionit juridik dhe publik, ku ofrohet përkujdesje dhe shërbime adekuate sociale profesionale si dhe forma të mbrojtjes sociale në bashkëpunim me partnerët tjerë për çdo kategori të qytetarëve në nevojë sociale e familjare komfor legjislativ në fuqi që ndërlidhet me këto shërbime. Shërbimet rezidenciale institucionale ofrohen përmes Shtëpisë së Komunitetit për persona me aftësi të kufizuara mendore në Shtime. Ky shërbim ka kaluar në kompetencë dhe menaxhim të DSHMS - së nga 1 janari i vitit 2016 në bazë të marrëveshjes së Mirëkuptimit të lidhur në mes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komunës së Shtimes e nënshkruar nga Ministri dhe Kryetari dhe tani Komuna Shtimes është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve rezidenciale - institucionale nën mbikëqyrjen e MPMS.

Ofrimi i shërbimeve rezidenciale kryhet duke u bazuar në programin e shërbimeve të identifikuar në përputhshmëri me standardet minimale të caktuara duke respektuar rregulloret, udhëzimet administrative, ligjet dhe procedurat e përcaktuara nga MPMS.

Shtëpia e Komunitetit për persona me aftësi të kufizuara mendore në Shtime ka kapacitet prej 12 shtretërve dhe janë 10 punëtorë që kryejnë këto shërbime. Organizimi i punës në këtë Qendër bëhet në orar 24 orësh pandërprerë.

¹¹Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale



2.5.5. Buxheti i Komunës

Buxheti Komunal¹² sigurohet prej dy burimeve: grantet nga qeveria qendrore dhe të hyrat vetanake.

Më poshtë janë paraqitur të dhënat për buxhetin shpenzuar të komunës së Shtimes për vitet 2015, 2016, 2017 dhe 2018.

Tabela 6. Shpenzimi i Buxheti sipas viteve

Viti buxhetor	Paga & Mëditje	Mallra & Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione & Transfere	Shpenzime Kapitale	Gjithsej
2015	3,751,002.09	410,389.69	162,222.19	136,692.40	1,333,966.86	5,794,273.23
2016	3,881,699.47	513,537.53	170,077.72	161,268.50	1,488,109.47	6,214,692.69
2017	3,904,629.32	504,902.05	166,620.72	118,405.75	1,583,022.79	6,277,580.64
2018	4,076,787.00	717,708.00	169,650.0	194,279.00	2,593,868	7,752,292.00

Tabela 7. Buxhetit i planifikuar për vitin 2019

Paga & Mëditje	Mallra & Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione & Transfere	Shpenzime Kapitale	Gjithsej
4,187,283	830,000	199,068	131,766	1,885,868	7,233,985

Tabela 8. Projektionet e shpenzimeve buxhetore Komunale

Viti buxhetor	Paga & Mëditje	Mallra & Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione & Transfere	Shpenzime Kapitale	Gjithsej
Plani Buxhetor 2019	4,187,283	830,000	199,068	131,766	1,885,868	7,233,985
Vlerësimi i hershem 2020	4,187,283	830,000	199,068	131,766	2,114,618	7,462,735
Vlerësimi i hershëm 2021	4,187,283	850,936	199,068	131,766	2,346,074	7,715,127

¹² Sektori i financave



3. PËRMBLEDHJA E ANALIZËS SWOT

Tabela 9. SWOT Analiza

FAKTORËT	TË BRENDSHËM	TË JASHTËM
POZITIVË	Përparësitë - Pozita e volitshme gjeografike, sepse Shtimja është udhëkryq i rrugëve kryesore magjistrale: Prizren-Shkup dhe Prishtinë-Prizren - Resurset njerëzore (mosha e re) - Resurset natyrore (toka, pyjet, guri gëlqeror, lumi Shtimjanja etj.) - Kompleksi përkujtimor i Raçakut - Tradita e punimit artizanal dhe tregtisë - Zona Ekonomike në Shtime-Parku Teknologjik - Kultura e punës në ndërmarrje të vogla dhe të mesme sidomos në lëmin e bujqësisë - Infrastruktura fizike në kompletim e sipër Numri në rritje i të diplomuarve në fusha të ndryshme - Ekspertë të dëshmuar të bujqësisë.	Mundësitë - Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Kosovës - Prania dhe bashkëpunimi me organizata dhe fondacione të huaja - Krijimi i kushteve për investime në sektorin e bujqësisë dhe turizmit rural - Implementimi i zonave ekonomike, turistike, rekreative dhe të banimit - Orientimi në ngritjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme - Përmirësimi i kushteve për kredi - Stimulimi me ligj i prodhimit vendor - Funksionalizmi e shkollave profesionale - Stimulimi i prodhimit vendor me ligj.
NEGATIVË	Dobësitë - Paqëndrueshmëria e politikave qendrore - Mungesa e plotë e legjislacionit dhe mos zbatimi i legjislacionit ekzistues - Politikat fiskale jo të favorshme	Rreziqet - Ndikimi negativ i politikave qendrore - Prania e tregtisë informale, konkurrencës së pandershme dhe evazioni fiskal



	- Mungesa e pronave të duhura komunale që do të mund të destinoheshin për zhvillim ekonomik - Kontestet pronësore-juridike - Orientimi i gabuar i subjekteve afariste vetëm në tregti dhe shërbime e jo në prodhim - Zënia e tokave bujqësore me ndërtime - Buxheti i vogël për projekte kapitale - Vetëdija e ulët për pagesën e taksave.	- Ndikimi i faktorëve jo të qëndrueshëm ekonomik (inflacioni, interesi i lartë i kredive bankare) - Mungesa e investimeve të huaja - Burokracia e institucioneve - Mungesa e informacioneve adekuate për investitorë të huaj për fushat e mundshme të investimit. - Mungesa e infrastrukturës ligjore për joshjen e investitorëve të huaj.
--	--	--



4. VIZIONI

Krijimi i politikave për zhvillim ekonomik lokal duke mundësuar zhvillimin e bizneseve, agrobizneseve, turizmin, bujqësinë, resurset njerëzore dhe natyrore për të arritur një qëndrueshmëri të ekonomisë lokale në mënyrë që të rrisë mirëqenien e jetesës së qytetarëve në të gjitha fushat.



5. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT

QËLLIMI 1: KRIJIMI I KUSHTEVE TË FAVORSHME PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Q1 – Objektivi 1: Krijimi i zonës ekonomike në Gllavicë prej 37.5ha me kapacitet prej 40 bizneseve në periudhë kohore 2019 – 2022;

Q1 – Objektivi 2: Formalizmi i të gjitha zonave të biznesit në periudhën 2019 – 2020

Q1 – Objektivi 3: Mbështetja me grande të 10 Start - Up bizneseve deri në vitin 2022

Q1 – Objektivi 4: Funkcionalizimi i zonave të biznesit

QËLLIMI 2: KRIJIMI I KUSHTEVE FAVORSHME PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË

Q2 – Objektivi 1: Rregullimi i infrastrukturës prej 25kmsë tokës bujqësore në periudhën kohore 2019 – 2022

Q2 – Objektivi 2: Mbështetja e 150 fermerëve dhe bujqve me grande dhe subvencione në periudhën kohore 2019 – 2022 përmes subvencioneve komunale dhe donatorëve të jashtëm

Q2 – Objektivi 3: Sektori për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural përmes Zyrës Këshillimore do të angazhohet për mbështetjen e bujqësisë përmes subvencioneve nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, komuna, donatorët dhe OJQ - të me vlerë financiare rreth 2,000,000.00€ për periudhën 2019 - 2022;

QËLLIMI 3: KRIJIMI DHE FUNKSIONALIZIMI I ZONËS TURISTIKE NË MOLLOPOLC, DEVETAK DHE LLANISHT

Q3 – Objektivi 1: Shpallja e zonës turistike (Mollopolc, Devetak dhe Llanisht) deri në vitin 2020

Q3 – Objektivi 2: Hartimi i planit rregullues dhe rregullimi i infrastrukturës bazë në zonën turistike deri në 2020

Q3 – Objektivi 3: Promovimi i zonës turistike

Q3 – Objektivi 4: Mbështetja në zhvillimin e agroturizmit në tri zonat turistike – Llanisht, Rancë dhe Dugë deri në vitin 2022

QËLLIMI 4: PËRDORIMI I RESURSEV NATYRORE PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Q4 – Objektivi 1: Përcaktimi i zonave për shfrytëzim të gurit dhe mineraleve si dhe caktimi i kushteve për shfrytëzimin e tyre



Q4 – Objektivi 2: Përcaktimi i zonave për prodhimin e energjisë, ujit të pishëm dhe kultivimin e peshkut

Q4 – Objektivi 3: Eksplorimi, promovimi dhe funksionalizimi i trashëgimisë historike dhe kulturore

QËLLIMI 5: PËRMIRSIMI I INFRASTRUKTURËS FIZIKE NË FUNKSION TË ZHVILLIMIT EKONOMIK

Q5 – Objektivi 1: Deri në fund të vitit 2019 të hartohet Plani Hartave Zonale dhe të fillojë implementimi i tij;

Q5 – Objektivi 2: Deri në fund të vitit 2020 të hartohet projekti ideor fizik për Zonën Ekonomike në Gllavicë;

Q5 – Objektivi 3: Nëpërmjet investimeve kapitale të arrihet rregullimi i infrastrukturës fizike në 70% deri në vitin 2022;

QËLLIMI 6: TË PËRMIRËSOHET SISTEMI ARSIMOR DHE KUSHTET PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Q6 – Objektivi 1: Arsimi i mesëm të orientohet nga kërkesat e tregut dhe të punësimit duke avancuar praktikën e nxënësve në Shkollën e Mesme Profesionale në periudhën 2019 - 2022;

Q6 – Objektivi 2: Të stimulohen kuadrot deficitare për arsim superior, deri në vitin akademik 2022 të rritet numri i bursistëve për secilin vit nga 10%;

Q6 – Objektivi 3: Të zbatohet Plani Strategjik për Arsimin në Komunën e Shtimes me aplikimin e mësimin tërë ditë dhe pajisjen me kabinete dhe teknologji kompjuterike në periudhën 2019 - 2022.

Q6 – Objektivi 4: Rregullimi i infrastrukturës për trashëgimi kulturore dhe rregullimi i hapësirave për rekreacion

QËLLIMI 7: PËRMIRËSIMI SHËRBIMEE PUBLIKE DHE RUAJTJA AMBIENTI EKOLOGJIK



Q7 – Objektivi 1: Ndërtimi i kolektorëve të ujërave të zeza nga Carraleva deri në Shtime, Mollopolci deri në Shtime dhe nga Shtimja deri në Vojnovc përkatësisht përfshirja e rreth 80% e territorit të komunës për 2019 – 2022

Q7 – Objektivi 2: Menaxhimi i lumenjve në territorin e Komunës nga 50% sa është tani në 90% deri në vitin 2022

Q7 – Objektivi 3: Menaxhimi i mbeturinave të amvisërisë dhe inerte nga 65% sa është tani në 90% deri në vitin 2022.

QËLLIMI 8: PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE NË SHËNDETËSI

Q8 – Objektivi 1: Rregullimi i infrastrukturës fizike



6. AKTIVITETET DHE SPECIFIKIMI I PROJEKTEVE

Tabela 10: Aktivitetet dhe specifikimi i projekteve

Qëllimet	Objektivat	Aktivitetet	Projektet
QËLLIMI 1: KRIJIMI I KUSHTET E FAVORSHME PËR ZHVILLIMIN E BIZNESEVE	Q1 – O1: Krijimi i zonës ekonomike në Gllavicë prej 37.5ha me kapacitet të 40 bizneseve deri në periudhën 2019 – 2022	A1: Shpallja e zones në Gllavicë	A1 - P1: Përkuftizimi i zonës së biznesit në Gllavicë
			A1 - P2: Hartimi i planeve dhe dokumentëve për miratim nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
		A2: Studimi i fizibilitetit për Zonën Ekonomike në Gllavicë	A2 - P1 Hartimi i planit për studim të fizibilitetit
			A2 - P2: Implementimi i planit të fizibilitetit
		A3: Promovimi i zonës së biznesit	A3 - P1: Fushata për Promovimin e hapsirave për biznes
		A4: Funkcionalizimi i zonave të biznesit	A4 - P1: Rregullimi i Infrastrukturës fizike në zonën e biznesit në Gllavicë
			A4 - P2: Shpallja e konkurseve për vendosje të bizneseve në parcela brenda Zonës Ekonomike Gllavicë 2019 - 2022
	Q1 - O2: Formalizimi i të gjitha zonave të biznesit në periudhën 2019 – 2020	A1: Lejimi i zonave për veprimtari biznese dhe industri	A1: P1 : Hartimi i hartave zonale
			A1:P2: Plani rregullues komunal
	Q1- O3: Mbështetja me grante të 10 Start - Up bizneseve deri në vitin 2022	A1: Plani për financimin e Start Up bizneseve	A1 - P1: Prezantimi i plan bizneseve inovative dhe teknologjike
QËLLIMI 2: KRIJIMI I KUSHTËVE TË FAVORSHME PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË	Q2 – O1: Rregullimi i infrastrukturës prej 25kmsë tokës bujqësore në periudhën kohore 2019 – 2022	A1: Programi për infrastrukturën fizike në bujqësi	A1 - P1: Rregullimi i rrugëve bujqësore me zhavorr në Shtime
			A1-P2 Rregullimi kanaleve kulluese të ujërave atmosferik për tokat bujqësore në Shtime dhe fshatrat e rrafshit
	Q2 – O2: Mbështetja e 200 fermerëve dhe bujqve me grante dhe	A1: Programi për mbështetjen e	A1 - P1: Projekti për bashkëpunime me donatorë të jashtëm



	subvencione në periudhën kohore 2019 – 2022 përmes subvencioneve komunale dhe donatorëve të jashtëm	fermerëve dhe bujqve	A1 - P2 Këshillimi dhe trajnimi i 200 fermerëve dhe bujqve për zhvillimin e bujqësisë
			A1 - P3 Projekti për ndarjen e subvencioneve për fermerët dhe bujqve
	Q2 - O3: Sektori për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural përmes Zyrës Këshillimore do të angazhohet për mbështetjen e bujqësisë përmes subvencioneve nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, komuna, donatorët dhe OJQ - të me vlerë financiare rreth 2,000,000.00€ për periudhën 2019 - 2022	A1: Programi për stimulimin e fermerëve	A1 - P1: Njoftimi dhe organizmi i takimeve informuese për subvencionet e shpallura nga MBPZHR
			A1 - P2: Njoftimi dhe organizmi i takimeve informuese për subvencionet e shpallura nga komuna në partneritet me OJQ-të dhe donatorët
QËLLIMI 3: KRIJIMI DHE FUNKSIONALIZIMI I ZONËS TURISTIKE NË MOLLOPOLC, DEVETAK DHE LLANISHT	Q3 – O1: Shpallja e zonës turistike (Mollopolc, Devetak dhe Llanisht) deri në vitin 2020	A1: Shpallja e zonës turistike	A1 - P1: Përkufizimi i zonës turistike
			A1-P2 : Hartimi i planit ideor për zonën turistike
